



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

---

VENDIM

Nr 7 , Datë 17.06 2013

Për

Miratimin e projekt-zbatimit për "Rehabilitimin e digave ekzistuese  
Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë".

Në zbatim të pikës dh. neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000. "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 9, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2442 prot, datë 27.05.2013 në mbledhjen e datës 03.06.2013, mori në shqyrtim projekt-zbatimin për "Rehabilitimin e digave ekzistuese Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë" nga projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.

Mbasi u prezantua projekt-zbatimi nga përfaqësuesit e grupit të projektimit Mott MacDonald në datë 03.06.2013, Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha pasi diskutoi lidhur me projekt-zbatimin e digave ekzistuese Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë".

Projekt-zbatimi është miratuar në bazë të Vendimit Nr.5, datë 20.05.2013 të Projekt-idesë për "Rehabilitimin e digave ekzistuese Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë".

Vendosi:

Të miratojë projekt-zbatimin për "Rehabilitimin e digave ekzistuese Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë".

PERI DISHINICA  
KRYETAR